



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. _____ prot.

Tiranë, më 3.10.2022

Lënda: Kthim përgjigjeje kërkesës suaj për informacion, të datës 20.9.2022.

ZNJ. D T.

INSTITUTI I STUDIMEVE POLITIKE

Adresa: Rruga "Luigj Gurakuqi", Shk. A, Pallati nr. 89, Kati 3, Ap. 16/A, Tiranë
Të dhënat e kontaktit: e-mail: _____; Cel.: _____

E nderuar znj. T

Në përgjigje të kërkesës juaj për informacion, datë 20.9.2022, e cila është protokolluar pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit me nr. _____ prot., datë 20.9.2022, bashkëlidhur ju vëmë në dispozicion listat emërore të subjekteve të rivlerësimit sipas funksionit, të cilët janë shkarkuar apo dorëhequr me vendim të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

Ju informojmë se deri në datën 26.9.2022, Komisioni ka shkarkuar nga detyra 209 subjekte rivlerësimi. Të dhënat mbi datën e vendimit për çdo subjekt, kriteret e rivlerësimit dhe arsyet e shkarkimit i gjeni në tabelën bashkëlidhur.

Sa i takon subjekteve të dorëhequra nga detyra, sqarojmë se, neni G i Aneksit të Kushtetutës parashikon të drejtën e dorëheqjes nga detyra të subjekteve që i nënshtrohen këtij procesi. Në këto raste Komisioni vendos të ndërprerë procesin e rivlerësimit dhe sipas pikës 2 të nenit G, u ndalon subjekteve të drejtën për tu emëruar në sistemin e drejtësisë për një periudhë 15-vjeçare. Deri më sot, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit ka ndërprerë procesin e rivlerësimit sipas kësaj dispozite kushtetuese, për 84 subjekte gjithsej.

Për më tepër informacion referojuni vendimeve të arsyetuara dhe të publikuara në faqen zyrtare të internetit, kpk.al.

Duke ju uruar punë të mbarë, shpresojmë të kemi përmbushur të plotë kërkesën tuaj.

KRYEDENJARI I DEPARTAMENTIT

Elbhan Dervishi

